



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**  
**VENDIM**

*Nr. 153, Datë 28.09.2017*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË TRANSMETIMIT TË  
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16 pika 11; nenit 22; neni 23; neni 35 të Ligjit 102 /2015 “Mbi Sektorin e Gazit Natyror “ si dhe nenit 19 pika 1 gërma “F” të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e Licencës së Transmetimit të Gazit Natyror, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

- Neni 22 pika 1 e Ligjit nr. 102/2015” Për Sektorin e Gazit Natyror “ përcakton së çdo person juridik, që kryen një veprimtari në sektorin e gazit natyror, sipas pikës 2, të këtij neni, duhet të pajiset me licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
- Neni 22, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” përcakton se: ERE lëshon licenca, ndër të tjera, dhe për veprimtarinë e transmetim të gazit natyror

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për miratimin e Licencës së Transmetimit të Gazit Natyror.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**  
**Petrit AHMETI**